

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6195
E shtunë, 19 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

PDK-ja kërkon që vendi të shkojë në zgjedhje të reja **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

UDHËHEQËSIT E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK), HYSNI GUCATI DHE NASIM HARADINAJ, JANË PARAQITUR TË PREMTEN PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË **FAQE 4-5**

GUCATI THOTË SE JANË TË PAFAJSHËM, HARADINAJ E QUAN SPECIALEN TË KORRUPTUAR



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e parë para gjykatësit të procedurës

paraprake, pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij. Paraqitja e Gucati para Dhomave të Specializuara u bë disa orë pasi të premten para kësaj gjykate u paraqit edhe nënkryetari i



OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, i cili ka treguar se nuk e ka lexuar aktakuzën, pasi ka thënë se Gjykata Speciale është politike, selektive, e njëanshme dhe e korruptuar

OPINION

KOSOVA PËRBALLË METODAVE ASIMETIRKE TË LUFTËS SPECIALE F. 11

Hisen BERISHA



AKTUALE



GJENDEN MBETJE MORTORE NË RAHOVEC DHE PRIZREN F. 7

UNICEF-i DHURON 633 TABLETË PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA F. 7

EKONOMI

GUVERNATORI MEHMETI DHE AMBASADORI KOLLY FLASIN PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË EKONOMI F. 8

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT BILATERAL NË MES TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË SUEDISË DHE ASAJ TË KOSOVËS F. 9



KULTURË

PËRFUNDUAN PUNIMET PËR RENOVIMIN E URËS SË MARASHIT F. 11

NGA JAVA E ARDHSHE MASATË REJA KUNDËR COVIDIT **FAQE 3**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19 si dhe janë paraqitur 385 raste të reja. Po ky

institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 351 persona nga Covidi. Pas publikimit të këtyre rezultateve, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se nga java e ardhshme do të



ketë masatë të reja kundër Covidit. Ai ka thënë se masatë aktuale do të mbesin në fuqi sipas komunave



HOTI: ISHTE NJË GJYSMËVJETOR DHE NJË VIT I VËSHTIRË **FAQE 6**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princasha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pompeo: Sistemi raketor rus në Turqi rrezikon sigurinë amerikane

UASHINGTON, 18 DHJETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se blerja e sistemit raketor rus nga ana e Turqisë rrezikon sigurinë e personelit dhe të teknologjisë ushtarake amerikane si dhe i mundëson Rusisë qasje në forcat e armatosura turke dhe në industrinë e mbrojtjes. Pompeo i bëri këto komente në një bisedë telefonike me ministrin e Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, pak ditë pasi ShBA-ja i vendosi sanksione Turqisë. Pompeo tha se qëllimi i sanksioneve është ta

parandalojnë Rusinë nga sigurimi i të ardhurave të konsiderueshme, qasjes dhe ndikimit. Ai tha se sanksionet nuk kanë për qëllim t'i minojnë aftësitë ushtarake ose gatishmërinë luftarake të Turqisë ose të ndonjë aleati tjetër të ShBA-së. Shtetet e Bashkuara vendosën sanksione ndaj Turqinë më 14 dhjetor për shkak të blerjes së sistemit raketor S-400 nga Rusia. Sanksionet goditën organin më të lartë të mbrojtjes në Turqi, i njohur si Presidenca e Industrive të Mbrojtjes.

Uashingtoni ka bërë përpjekje ta bindë Ankaranë që të heqë dorë nga blerja dhe instalimi i sistemit rus, duke e paralajmëruar se ai do ta rrezikojë sigurinë e teknologjisë dhe personelit ushtarak të ShBA-së dhe Turqisë. Pasi Turqia ka realizuar blerjen, ShBA-ja ka larguar Turqinë nga programi i aeroplanëve luftarakë F-35, ndërsa ka vazhduar negociatat me Ankaranë. Zyrtarë të Departamentit të Shtetit Amerikan kanë thanë se sanksionet janë ndërmarrë pasi negociatat kanë dështuar.



Zëvendëspresidenti amerikan merr vaksinën kundër Covidit



UASHINGTON, 18 DHJETOR - Zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara, Mike Pence, mori të premtën vaksinën kundër Covid-19. Ai mori dozën e parë të vaksinës Pfizer/BioNTech në Shtëpinë e Bardhë, së bashku me gruan e tij, Karen, dhe mjekun Jerome Adams. Ngjarja u transmetua drejtpërdrejt në televizion.

Pence tha se vakcina është "e sigurt dhe efektive" dhe se shpejtësia me të cilën është zhvilluar është "mrekulli mjekësore". Shtëpia e Bardhë tha se transmetimi i vaksinimit të Pence në televizion ka për qëllim "të promovojë sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës dhe të krijojë besim të popullit amerikan". ShBA-ja ka nisur të hënën

vaksinimin e popullatës me vaksinën Pfizer/BioNTech. Vakcina është thënë se është 95 për qind efektive. Tre milionë dozat e para të saj po shpërndahen në të 50 shtetet e ShBA-së. ShBA-ja ka regjistruar numrin më të madh të të infektuarve dhe viktimave nga Covid-19. Këtë javë numri i të vdekurve kaloi 300 000.

Gjykata më e lartë e BE-së mbështet kufizimet për therje të kafshëve

BRUKSEL, 18 DHJETOR - Gjykata më e lartë në Bashkimin Evropian ka mbështetur një ligj belg që parasheh humbjen e vetëdijes së kafshëve para therjes, duke kundërshtuar kështu kërkesat e grupeve hebreje dhe atyre myslimane, dhe duke hapur rrugën që edhe shtetet e tjera të miratojnë kufizime të ngjashme. Aktivistët për të drejtat e kafshëve kanë miratuar këtë rregull që kufizon disa rite fetare. Ambasadori izraelit në Belgjikë dhe Luksemburg, Emmanuel Nahshon, e ka quajtur këtë vendim

"katastrofik dhe goditje për jetën e hebrenjve në Evropë". Asociacionet e hebrenjve dhe myslimanëve kanë argumentuar se dekreti origjinal i hartuar në Belgjikë më 2017, i ka bërë të paligjshme mënyrat tradicionale të therjes së kafshëve. Ata kanë thënë se metodat e tyre të therjes së fytyrës të kafshëve me thikë të mprehtë, ka rezultuar me vdekje të menjëhershme dhe se humbja paraprake e vetëdijes nuk është e lejuar. Mirëpo gjykata me bazë në Luksemburg ka gjetur se

dekreti belg është në linjë me ligjin e Bashkimit Evropian. Gjyqtarët kanë gjetur se ligji në fjalë kufizon vetëm një aspekt të traditave fetare dhe se nuk ndalon praktikën në përgjithësi. Ambasadori Nahshon ka thënë përmes "Twitter"-it: "Duket se toleranca dhe diversiteti janë fjalë boshe në sytë e disa evropianëve". Grupi belg, Veprimi Global në Interes të Kafshëve, ka thënë se është i gëzuar nga ky vendim, duke thënë se u mundëson edhe vendeve të tjera të bllokut evropian që të miratojnë masa të ngjashme.



Gjermania me rekord rastesh të reja me Covid



BERLIN, 18 DHJETOR - Gjermania raportoi të premtën për 33 777 raste të reja me koronavirus, të konfirmuara në 24 orët e fundit. Kjo është hera e parë që Gjermania regjistron mbi 30 000 raste të reja në ditë.


Instituti "Robert Koch" raportoi edhe për 813 viktima të premtën. Kjo është shifra e dytë më e lartë e viktimave, prejse ka nisur pandemia në muajin mars. Në total, Gjermania ka regjistruar mbi 1.4 milion të

infektuar dhe gati 25 000 viktima. Vendi është futur këtë javë në një bllokadë të ashpër, duke mbyllur shkollat dhe bizneset jothelbësore, për ta frenuar rritjen e mprehtë të infektimeve me koronavirus. Masat do të jenë në fuqi deri

më 10 janar, ndërsa do të lehtësohen fare pak për Krishtlindje. Lothar Wieler, udhëheqës i Institutit "Robert Koch", i cili mbikëqyr situatën me koronavirus në Gjermani, ka thënë se gjendja është "më serioze se kurrë".

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Shtatë të vdekur, 351 të shëruar dhe 385 raste të reja me Covid

Nga java e ardhshme masa të reja kundër Covidit



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19 si dhe janë paraqitur 385 raste të reja. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 351 persona nga Covidi. Pas publikimit të këtyre rezultateve, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se nga java e ardhshme do të ketë masa të reja kundër Covidit. Ai ka thënë se masat aktuale do të mbesin në fuqi sipas komunave

personave të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 1 240 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 351 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 35 790 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 307”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të reja me Covid. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 153 raste, Pejë 37 raste, Podujevë 34 raste, Ferizaj 30 raste, Gjakovë 19 raste, Fushë-Kosovë 15 raste, Gjilan 12 raste, Vushtrri 10 raste, Drenas 9 raste, Istog 8 raste, Klinë 8 raste, Lipjan 8 raste, Obiliq 7 raste, Mitrovicë 6 raste, Prizren 6 raste, Suharekë 6 raste, Rahovec 4 raste, Kamenicë 3 raste, Viti 3 raste, Kaçanik 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Deçan, Hani Elezit, Novobërdë, Shtime dhe Skenderaj”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Zemaj: Nga java e ardhshme, masa të reja kundër Covidit

Menjëherë pas publikimit të raportit 24-orësh nga IKShPK-ja, ministri i Shëndetësisë,

Armend Zemaj, ka paralajmëruar masa të reja në gjithë vendin nga java e ardhshme. Zemaj në një konferencë për media ka thënë se gjatë kësaj jave ka pasur rënie të numrit të infektuarve me Covid-19, ku edhe ka ndryshuar renditja e komunave sa i takon situatës epidemiologjike. “Masat aktuale do të mbesin në fuqi për komunat sipas zonave, por do të ketë masa të reja nga java e ardhshme për gjithë vendin”, ka thënë Zemaj. Ai ka bërë me dije se renditja e re e komunave, ku në zonën e kuqe nga 16 komuna sa kanë qenë, tani janë 11, kurse në zonën e gjelbër janë 16 komuna. Në zonën e kuqe janë: Prishtina, Zveçani, Zubin Potoku, Fushë Kosova, Obiliqi, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Lipjani, Drenasi dhe Podujeva. Në zonën e verdhë janë: Kamenica, Klllokoti, Gjakova, Viti, Gjilani, Peja, Vushtrria, Ferizaj, Shtërpca, Istogu dhe Ranillugu, kurse në zonën e gjelbër janë: Graçanica, Klina, Hani i Elezit, Shtimja, Suhareka, Rahoveci, Skenderaj, Parteshi, Prizreni, Malisheva,

Deçani, Novobërdë, Kaçaniku, Juniku, Dragashi dhe Mamusha. Më tutje, Zemaj në këtë konferencë ka folur edhe për sigurimin e vaksinës Covid-19. Ai ka thënë se janë të përkushtuar ta sigurojnë këtë vaksinë. Zemaj ka thënë se për këtë janë formuar një komision dhe një grup punues. “Ju sigurojmë që kemi marrë me kohë masa dhe jemi të përkushtuar t’i kemi sa më parë këto vakcina. Po bashkëpunojmë me mekanizmat e BE-së dhe shtetet e tjera të zhvilluara”, ka thënë Zemaj.

Ndërsa ushtruesi i detyrës i drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka thënë se gjendja në spitalet e Kosovës është e rënduar si pasojë e përhapjes së Covidit. Në këtë kontekst, Krasniqi ka konfirmuar se 795 pacientë janë të shtrirë në spitalet e Kosovës, prej tyre 51 janë në gjendje të rëndë. “795 pacientë janë duke u mjekuar në të gjithë vendin, 51 janë në gjendje kritike sepse janë të kyçur në aspiratorë”, ka thënë Krasniqi.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 385 raste të reja dhe janë shëruar 351 persona të infektuar me Covid. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në

IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 442 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 385 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 7 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Klinë 2 raste (80, 73 vjeç), Prizren 1 rast (76 vjeç), Deçan 1 rast (86 vjeç), Gjakovë 1 rast (69 vjeç), Gjilan 1 rast (64 vjeç), Graçanicë 1 rast (73 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 48 337 raste nga 169 653

Infermieri Duraku pezullon grevën, sindikata i jep afat qeverisë deri javën tjetër



Prishtinë, 18 dhjetor (ER) - Sekretari i Sindikatës së Infermierëve të Kosovës, Enlirat Duraku, ka ndërprerë grevën e nisur disa ditë më parë. Lajmin e ka dhënë, në një konferencë për medie, kryetari i kësaj sindikate, Fitim Havolli. Ai ka thënë se pas kërkesës së kryeministrit Avdullah Hoti, i kanë dhënë afat qeverisë deri javën tjetër që të përmbushet kërkesa e vetme e tyre: dyfishimi i

pagesës së kujdestarisë nga 18 në 36 euro. “Pas një thirrje që më bëri kryeministri dhe më luti që takimi të shtyhet për javën tjetër, nga e hëna deri të enjten, në mënyrë që t’i japë fund kësaj kërkesë tone, pra dyfishimi i pagës së kujdestarisë nga 18 euro në 36 euro. Falënderoj sekretarin i cili ka suspenduar grevën për shkak të gjendjes së tij. Presim që në javën e ardhshme kjo

kërkesë të marrë fund”, ka thënë Havolli. Ndërsa Enlirat Duraku, pas grevës njëmbëdhjetëditore, ka thënë se pas propozimit të kryetarit Havolli ka marrë vendim që ta ndërpresë grevën. “Greva ime ndërpritet sot, por në të ardhmen, nëse nuk merren për bazë kërkesat tona, do të marrim prapë vendime sindikale”, është shprehur Duraku.



UDHËHEQËSIT E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (OVLUÇK), HYSNI GUCATI DHE NASIM HARADINAJ, JANË PARAQITUR TË PREMTEN PARA DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË

GUCATI THOTË SE JANË TË PAFAJSHËM, HARADINAJ E QUAN SPECIALEN TË KORRUPTUAR

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati, është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e parë para gjykatës të procedurës paraprake, pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij. Paraqitja e Gucati para Dhomave të Specializuara u bë disa orë pasi të premten para kësaj gjykate u paraqit edhe nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, i cili ka treguar se nuk e ka lexuar aktakuzën, pasi ka thënë se Gjykata Speciale është politike, selektive, e njëanshme dhe e korruptuar

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe nënkryetari i saj, Nasim Haradinaj, janë paraqitur të premten në paraqitjen e parë para gjykatës të procedurës paraprake.

Gucati është deklaruar i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës. "Në të gjitha pikat që m'u lexuan ndihem i pafajshëm dhe plotësisht i pafajshëm", ka thënë Gucati të premten para

Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale, me seli në Hagë. Ai ka thënë se është e drejtë e tij që t'i mbrojë vlerat e UÇK-së. "Ne nuk e kemi pushtuar Serbinë. Ne jemi të pafajshëm. Unë kam të drejtën e lirisë dhe shprehjes dhe të drejtën e shprehjes së mendimeve të mia. Është e drejtë e imja që në mënyrë të ligjshme t'i mbrojmë vlerat e kombit shqiptar dhe të UÇK-së dhe do të vazhdoj t'i mbrojmë këto vlera deri në fund", ka thënë ai.

Paraqitja e Gucati para Dhomave të Specializuara u bë disa orë pasi të premten para

kësaj gjykate u paraqit edhe nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Nasim Haradinaj. Ky i fundit nuk është deklaruar lidhur me akuzat që ngarkojnë mbi të.

Në paraqitjen e tij të parë para gjykatës më 18 dhjetor, kur është pyetur nëse ka pranuar aktakuzën, Haradinaj ka thënë se nuk e ka lexuar këtë dokument. "Kam nënshkruar diçka, por të them të drejtën as që e kam lexuar", ka deklaruar ai.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Nicolas Guillou, më 11 dhjetor ka

konfirmuar aktakuzën ndaj Haradinajt dhe udhëheqësit tjetër të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati.

Në njoftimin e Dhomave të Specializuara më 14 dhjetor, është thënë se aktakuzat lidhet me "vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës".

Këto vepra penale dyshohet se janë kryer në periudhën 7-25 shtator 2020.

Nasim Haradinaj ka thënë të premten se Prokuroria Speciale është politike, selektive, e njëanshme dhe e korruptuar. "Për mendimin tim, kjo prokurori është së pari politike, selektive dhe e njëanshme. Por tani me këtë veprim të tyre, po dyshoj dhe po bindem se është edhe e korruptuar. Sepse

ndryshe nuk do të dilte gjithë ai material nga zyrat e tyre dhe si përfundim sheshazi po del se kjo prokurori, pos të tjerash, ka edhe dy qëllime, përpiket ta njollojë dhe ta humbë kuptimin e luftës sonë çlirimtare dhe luftëtarëve të saj dhe nën dy, po përpiket t'i dënojë përfaqësuesit e këtyre luftëtarëve", është shprehur Haradinaj. Sipas tij, OVL e UÇK-së nuk mund të fajësohet për, siç ka thënë ai, nxjerrjen nga sirtarët të këtyre dokumenteve. "Për mua dhe këdo që ka vetëm një pikë logjike, nuk ka si kuptohet ndryshe, vetëm se kjo prokurori dëshiron ta heqë vëmendjen e opinionit nga vetja dhe të kërkojë fajin diku tjetër. Ne duhet të përgjigjemi se pse ju dolën sekretet e tyre dhe u sollën mijëra kilometra larg në zyrat tona dhe mos harroni, ato nuk ishin as një, as dy fletë, por mijëra faqe. Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së nuk ka pasur qasje dhe nuk ka dhe as që mund të fajësohet për nxjerrjen nga sirtarët e tyre të"



këtyre dokumenteve”, ka deklaruar ai. Haradinaj ka thënë se Gjykata Speciale nuk ka çfarë të presë nga ai sepse dihet publikisht qëndrimi që ka për këtë trup. “Mohimi i faktit, duke anashkaluar se kush i nxori nga sirtarët e kësaj prokurorie këto dokumente, kush i solli në Kosovë, kush na i solli në selinë

tonë, dhe tani për këtë, ta mbajmë në përgjegjësinë e tyre, është çmenduri dhe aspak drejtësi. Kur dihet shumë qartë mendimi ynë për këto dhoma, pra ne të fajësohemi për t'i larë fajet e kësaj prokurorie, është absurd i kësaj prokurorie në drejtësinë e këtij shekulli”, ka thënë Nasim Haradinaj. Mes të tjerash, Haradinaj ka

thënë se tash e tutje do të përfaqësohet në gjykatë vetëm përmes avokatit. “Unë më nuk flas, por do të flas vetëm përmes avokatit”, ka deklaruar ai. Avokati i Haradinajt në këtë proces gjyqësor do të jetë Toby Cadman. Sipas aktakuzës, Gucati dhe Haradinaj “zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej

Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe nëpërmjet shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale”. Haradinaj dhe Gucati janë

arrestuar më 25 shtator në Prishtinë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, me mbështetjen e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX dhe të Policisë së Kosovës. Fillimisht nuk janë dhënë detaje për arsyet e lëshimit të fletarrestimeve, por më vonë është thënë se ata kanë penguar drejtësinë.

PDK-ja kërkon që vendi të shkojë në zgjedhje të reja

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, në një konferencë për medie mbajtur të premten, ka thënë se kjo qeveri ka një shumicë parlamentare e cila asnjëherë nuk arrin t'i ketë më shumë se 35 deputetë në Kuvend dhe po e mban peng vendin. Sipas tij, është momenti i duhur që Kuvendi të shpërbëhet dhe vendi të shkojë në zgjedhje

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Deputeti dhe sekretari organizativ i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, në një konferencë për media mbajtur të premten, ka shprehur zemërimin lidhur me sjelljen jointucionale të zyrtarëve dhe deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Tahiri i ka cilësuar veprimet e njëpasnjëshme të këtyre dy partive në seancat e Kuvendit të Kosovës si maskaradë, e cila është rezultat i mashtrimit më të madh që e kanë pësuar qytetarët e Kosovës në zgjedhjet

e 6 tetorit të vitit 2019. “Pra, si rezultat i atij koalicioni të zgjedhjeve, si rezultat i atyre shpresave të rreme, viti 2020 ka qenë viti më i rëndë, viti më degradues në secilin aspekt për shoqërinë dhe për shtetin tonë. Ky vend po udhëhiqet nga qeveria e dytë e koalicionit të shpresave të rreme, e cila vetëm hallin e qytetarëve nuk e ka. Çdo ditë na vdesin nga 15 deri në 20 qytetarë për shkak të moskujdesit për përballje me pandeminë Covid-19. Çdo ditë na ndodhin plaçka nëpër banka të ndryshme, nëpër qendra tregtare, po rritet kriminaliteti, po rriten zhatjet në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe, në anën tjetër, e



kemi një degradim të skajshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës si rezultat i këtij mashtrimit dhe kësaj keqqeverisjeje që ka dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019”, ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se aktualisht kemi një shumicë parlamentare e cila asnjëherë nuk arrin t'i ketë më shumë se 35 deputetë në

Kuvend dhe po e mban peng vendin dhe, sipas tij, ky është momenti i duhur që Kuvendi të shpërbëhet dhe vendi të shkojë në zgjedhje. “PDK-ja do t'i bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që ta ndalë këtë degradim, që ta ndalë vjedhjen e qytetarëve dhe taksapaguesve të Republikës së Kosovës. Pra, ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet që në të

ardhmen e afërt të shpërbëhet ky Kuvend dhe t'ua kthejmë besimin qytetarëve. Jemi të bindur që pas zgjedhjeve të ardhshme PDK-ja do të jetë partia që do t'i ofrojë stabilitet vendit me një qeverisje kredibile dhe një kryeministër kredibil dhe jo me mashtrues siç jemi keqqeverisur në vitin 2020”, ka thënë Tahiri.

Hoti: Ishte një gjysmëvjetor dhe një vit i vështirë

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 SHIATOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë vizitës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Dardania" në Prishtinë, çmoi lart rolin dhe angazhimin e të gjithë mësimit dhe përmbajtjes së përmbylljen me sukses të gjysmëvjetorit të parë. Ndërsa nxënësit i përgëzoi për përshtatjen me metodologjinë e mësimit kundrejt situatës së krijuar. "Ju falënderoj që, pavarësisht prej të gjitha vështirësive dhe ndërprerjeve që kanë ndodhur si pasojë e pandemisë, në masë të konsiderueshme keni arritur ta realizoni planprogramin, në mënyrë që nxënësit të mos mbeten prapa", tha kryeministri Hoti. Ai nënvizoi se ky ishte një gjysmëvjetor dhe

përgjithësisht një vit i vështirë për secilin pa përjashtim. Ndërkohë që shprehu besimin që prej 18 janarit 2021 mësimi të fillohet në kushte më të mira. "Statistikat e fundit na tregojnë se numri i arsimtarëve të prekur nga Covid-19, në raport me mjekët apo policët, është në përqindje më të lartë, që nënkupton se edhe ju jeni në vijën e parë të frontit në luftë me këtë armik të padukshëm, njëllor si profesionistët e tjerë", nënvizoi kryeministri Hoti. Gjatë vizitës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Dardania" në Prishtinë, kryeministri Hoti ishte i shoqëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj. Me këtë rast ai vlerësoi edhe punën e Ministrisë dhe angazhimin për adaptimin e metodologjisë mësimore karshi kushteve që janë krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19.



Hoxhaj me ambasadorin hungarez: PDK-ja vendos interesin qytetar para atij partiak



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga anëtari i kryesisë, deputeti Elmi Reçica, kanë takuar në seli të partisë ambasadorin e Hungarisë në Kosovë, Jozsef Bencze. Në këtë takim u diskutua për zhvillimet politike në Kosovë pas ngjarjeve me Gjykatën Speciale, rolin e PDK-së si parti opozitare dhe sjelljen e saj karshi disa temave nacionale dhe interesave të qytetarëve. "PDK-ja asnjëherë nuk do ta vendos interesin qytetar dhe të shtetit para atij partiak. E tillë ka qenë sjellja e PDK-së pas zgjedhjeve të 6 tetorit", ka thënë Hoxhaj në këtë takim. Hoxhaj e ka falënderuar

ambasadorin për mbështetjen e vazhdueshme të Hungarisë ndaj Kosovës në të gjitha fushat, dhe të dy janë pajtuar se ka ende shumë tema e projekte ku mund të bashkëpunohet. Një nga ta është projekti aktual shumëmilionësh i Hungarisë në Ferizaj ku do të investohet për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza që konsiderohet një nga projektet më të jashtëzakonshme në qytetin e Ferizajt të udhëhequr nga PDK-ja. Hoxhaj dhe Reçica e kanë falënderuar ambasadorin dhe shtetin e Hungarisë për këtë mbështetje dhe këtë projekt dhe nevojën që të vazhdohet edhe më tutje ky lloj bashkëpunimi në interes të qytetarëve të Kosovës.

Taulant Kryeziu zëvendëson Shpejtim Bulliqin në Kuvend

Prishtinë, 18 dhjetor (ER) - Taulant Kryeziu ka bërë betimin prej deputeti në Kuvendin e Kosovës. Kryeziu do ta zëvendësojë deputetin e Lëvizjes Vetëvendosje, Shpejtim Bulliqin, i cili tashmë është zgjedhur kryetar i Komunës së Podujevës. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Kryeziu ka thënë se kjo është dita më sublimë e angazhimit të tij publik. "Dua ta falënderoj në rend të parë familjen time e cila ka qenë çdoherë ylli ndriçues i jetës time. Pa të asgjë nuk do të ishte e mundur. Biseda e parë me Albin Kurtin

ishte edhe e fundit për t'iu bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje. Nuk më është dashur më shumë se një takim për të kuptuar se Albini është e vetmja mundësi për të ndërtuar një Republikë të drejtë, të barabartë dhe prosperuese. E falënderoj Albinin për mundësinë për t'iu bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje dhe për të ofruar një kontribut modest për ndërtimin e një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë. Duhet t'i falënderoj të gjithë votuesit dhe aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje!", ka shkruar Kryeziu. Ai ka theksuar se gara e 6 tetorit

ka qenë përvoja e tij më e bukur profesionale. "Tani e kam detyrim që mos t'ju zhgënjej sepse meritoni më të mirën e mundshme. Sot lirinë që ne e gëzojmë, ishte si një pishtarë që u bart brez pas brezi nga të gjithë atdhetarët, gra dhe burra të kombit tonë ndër shekuj. Kjo rezultoi me burgosjen e qindra e mijëra të rinjve dhe të rejave, por dëshira për liri ishte më e fortë se çdo gjë tjetër. Kjo sakrificë shekullore u kurorëzua me luftën më të shenjtë, të pastër e të ndritshme të luftëtarëve të UÇK-së, luftën për liri e pavarësi. Ata nuk kursyen atë



më të shtrenjtën, jetën për këtë ditë. Republika e Kosovës ua ka borxh brezave të udhëhequr nga presidenti Ibrahim Rugova, komandanti legjendar Adem Jashari, simboli i

rezistencës Adem Demaçi, për një Kosovë të begatshme e cila qëndron krah për krah me shtetet e tjera perëndimore si anëtare e NATO-së dhe BE-së", ka shkruar deputeti Kryeziu.

Gjenden mbetje mortore në Rahovec dhe Prizren

Të premten janë kryer gërmimet vlerësuese në dy lokacione, në hapësirën e varrezave të qytetit në Rahovec dhe në hapësirën e varrezave të qytetit në Prizren. Gërmimet në lokacionin në Rahovec kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore të një viktime të luftës, ndërsa edhe gërmimet në hapësirën e varrezave në lagjen Tusuz të Prizrenit kanë përfunduar me gjetjen dhe zhvarrosjen e disa pjesëve kockore të një viktime të luftës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka njoftuar se në kuadër të angazhimeve për zbardhjen e fatit dhe vendndodhjen e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, të premten janë kryer gërmimet vlerësuese në dy lokacione, në hapësirën e varrezave të qytetit në Rahovec dhe në hapësirën e varrezave të qytetit në Prizren.

Gërmimet vlerësuese të filluara në mëngjesin e së premtes në lokacionin në Rahovec kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore të një viktime të luftës.

Ndërsa gërmimet vlerësuese në

hapësirën e varrezave në lagjen Tusuz të Prizrenit kanë përfunduar me gjetjen dhe zhvarrosjen e disa pjesëve kockore të një viktime të luftës. Gërmimet dhe zhvarrosja e mbetjeve mortore në këto dy lokacione janë kryer nga ekspertët mjekoligjorë të Institutit të Mjekësisë Ligjore në zbatim të urdhëresave të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe me praninë e zyrtarëve të Sektorit të Policisë për Krime Luftë, zyrtarëve të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, kryetarit të fshatit Krushë e Madhe dhe zyrtarëve policorë të stacionit në Rahovec dhe Prizren.

Mbetjet mortore të zhvarrosura do të dërgohen për ekzaminim

mjekoligjor, ndërsa mostrat nga mbetjet mortore do të dërgohen për identifikim përmes analizës së ADN-së dhe pas identifikimit, do t'u dorëzohen për rivarrim familjeve të personave të identifikuar, në përpjekjen e vazhdueshme institucionale që familjet e të zhdukurve të

mësojnë sa më parë fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të zhdukur dhunshëm si pasojë e luftës së fundit në Kosovë.

Këto dy lokacione janë proceduar në bazë të informatave të prezantuara nga qytetarët në Komisionin

Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Sektorin e Policisë për Krime Luftë, andaj sërish apelojmë te çdo qytetar që mund të ketë informata për vendndodhjen e mundshme të personave të pagjetur, t'i ofrojnë këto informata tek institucionet kompetente.

UNICEF-i dhuron 633 tabletë për fëmijët me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka pranuar të premten 633 tabletë nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë, të cilët do t'u shpërndahen nxënësve me nevoja të veçanta.

Zyra e UNICEF-it në tërësi ka siguruar 800 tabletë përmes Ambasadës Britanike në Kosovë, 167 prej të cilëve janë shpërndarë tek organizatat e personave me nevoja të veçanta.

Ministri Ramë Likaj me këtë rast ka theksuar rëndësinë e të dhënave të sakta dhe raporteve të cilat Ministria e Arsimit i ka mbledhur nga DKA-të, sa i përket numrit të nxënësve me nevoja të veçanta që duhet të ndihmohen me teknologji asistive, përkatësisht me tabletë. Ministri Likaj ka folur edhe për rëndësinë



e digjitalizimit të procesit mësimor dhe rrjedhën e procesit mësimor gjatë periudhës së parë.

Shefja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Larisa Brunn, tha se fëmijët me aftësi të kufizuara janë

më të prekurit nga Covid-19. "UNICEF-i në bashkëpunim me Ambasadën Britanike po

ndihmojnë këta fëmijë për sigurimin e tabletëve duke kontribuar në qasjen e tyre në mësimin online", ka thënë ai.

Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Xhavit Rexhaj, ka theksuar se furnizimi i nxënësve me tabletë është përkrahje e çmueshme në kohë të pandemisë Covid-19. Rexhaj ka vlerësuar se ndihma e UNICEF-it vjen në një kohë të duhur dhe përdorimi i tabletëve tash ka peshë edhe më të madhe për shkak të organizimit të mësimin në distancë. Sipas të dhënave të vitit 2020, nga hulumtimi i MICS-it nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, del se vetëm 53 për qind e familjeve në Kosovë kanë kompjuter ose tabletë.

Vdes një i burgosur në Spitalin Rajonal të Pejës

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka njoftuar se të premten në spitalin rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri I. B., viti i lindjes

1951. I burgosuri gjatë qëndrimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë për një kohë të gjatë ishte duke u trajtuar në Stacionarin Shëndetësor të Qendrës. "Nga

data 03.12.2020, me rekomandim të mjekut të qendrës, është hospitalizuar në Spitalin Rajonal të Pejës ku, përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore, i njëjti ka ndërruar

jetë. Organet kompetente janë duke u zhvilluar procedurat ligjore, ndërsa autopsia do ta verifikojë shkaku e vdekjes", ka njoftuar Shërbimi Korrektues i Kosovës.



Kërkohet zgjatja e orarit të punës për bizneset



Prishtinë, 18 dhjetor (ER) - Përfaqësuesit e komiteteve të kujdesit shëndetësor dhe atij për gastronomi dhe turizëm brenda Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) janë takuar të premtën me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, si dhe zëvendësministrin e Shëndetësisë, Luan Gola, me të cilët kanë diskutuar për çështjet që ndërlidhen me masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbrojtje nga pandemia Covid-19 si dhe për mundësitë për bashkërendimin për zbatim të tyre në dobi të qytetarëve dhe bizneseve. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në

Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka theksuar se kjo odë ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që orari i kufizimit të lëvizjes të zgjatet, gjithnjë duke i respektuar masat e rekomanduara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) për mbrojtjen e shëndetit publik. Ndërsa ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, është shprehur se duke marrë parasysh fragjilitetin e ekonomisë së vendit, ministria që ai drejton është kundër mbylljes totale. Ai ka theksuar se tash e disa herë brenda komitetit për vlerësim të situatës me Covid-19 ka

avokuar për marrjen e masave strikte, por jo edhe për mbylljen e ekonomisë në tërësi. Gjithashtu, Krasniqi ka thënë se marrë parasysh fluksin e madh të mërgimtarëve, të cilët kanë rol kyç në buxhetin e vendit përmes remitencave, do t'i trajtojnë kërkesat e bizneseve për zgjatje të orarit, gjë që bëhet e mundur përmes vendosjes së rendit përmes inspektoratit dhe policisë, si dhe përmes zbatimit të masave strikte për mbrojtjen e shëndetit publik nga ana e bizneseve. Në anën tjetër, zëvendësministri i Shëndetësisë, Luan Gola, ka thënë se Ministria e

Shëndetësisë bashkë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, çdo masë e ka propozuar duke i marrë parasysh kapacitetet e limituara spitalore për t'u përballur me numër më të madh të të infektuarve. Më tutje, ai ka thënë se kuadri mjekësor është lodhur për shkak të punës shumë të madhe që është bërë gjatë këtyre 9 muajve, ndërsa shprehu shqetësimin e tij mbi situatën shumë serioze. Më tutje, Erëmal Bajrami, kryesues i Komitetit të Odës Amerikane për gastronomi dhe turizëm, ka theksuar se një ndër kërkesat kryesore të këtij komiteti ka qenë të lejohet shërbimi i shpërndarjes edhe

gjatë orëve kur lëvizja është e kufizuar, meqë një shërbim i tillë nuk paraqet rrezik për shëndetin publik dhe i njëjti po implementohet edhe në shtetet e tjera. Ai ka thënë se diçka e tillë duhet të implementohet sa më parë sepse çdo vonesë rezulton në humbje për ekonominë. Kurse Vullnet Kusari, përfaqësues i Komitetit të Odës Amerikane për kujdes shëndetësor, ka thënë se në rast të aplikimit të kufizimeve më të gjera të aktivitetit fizik, duhet të konsiderohet rritja e udhëtimeve jashtë vendit, e cila do të ndikojë në shtimin e rasteve të të infektuarve, por edhe në humbjen e potencialit ekonomik.

Më 23 dhjetor dalin paratë e Trustit



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Fondi i Kursimeve Pensionale ka dalë me datë të saktë se kur do të mund t'i tërheqin paratë

kontributdhënësit që kanë aplikuar për tërheqje të kursimeve në vlerë prej 10-përqindësh. Njëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare,

Trusti ka bërë me dije se për aplikimet që janë kryer prej datës 11 deri më 17 dhjetor, pagesat do të ekzekutohen më 23 dhjetor. "Të nderuar

kontribuues, për aplikimet që janë kryer prej datës 11 deri më 17 dhjetor, ekzekutimi i pagesës së 10-përqindëshit nga Trusti, siç

edhe është njoftuar gjatë aplikimit, pritet të bëhet më 23 dhjetor 2020", ka njoftuar Fondi i Kursimeve Pensionale.

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit bilateral në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe asaj të Kosovës

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Në vazhdim të bashkëpunimit të frytshëm shumëvjeçar, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës kanë avancuar të premtën bashkëpunimin bilateral me nënshkrimin e memorandumit "Bashkëpunimi për zhvillim institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023".

Memorandumi i bashkëpunimit, i nënshkruar nga Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani dhe Auditori i Përgjithshëm i Suedisë, Helena Lindberg, ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve organizative të ZKA-së që promovojnë punë me cilësi të lartë si dhe forcimin e kapacitetit për të përgatitur

raporte të auditimit të performancës me cilësi të lartë dhe të dobishme për shoqërinë. Me këtë rast, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka thënë se mundësia për t'i marrë përvojat suedeze është një rast unik për të përfutur dije dhe ngritur kapacitetet tona në fushën e auditimit të performancës dhe në modernizimin e organizimit institucional të ZKA-së. "Kjo ndihmë që vjen nga taksapaguesit suedeze, të cilëve u jemi pafundësisht mirënjohës dhe falënderues, si dhe angazhimi i personelit dhe ekspertëve të ISA-së suedeze na inkurajon drejt sukseseve të reja. Do të vazhdojmë të mbetemi të përkushtuar që ta maksimizojmë përfitimën nga ky projekt dhe të ecim krah për krah me institucionet supreme të auditimit në Evropë për sa i përket modernizimit të

procese dhe kryerjes së auditimeve cilësore", ka thënë Osmani.

Në anën tjetër, Auditori i Përgjithshëm i Suedisë, Helena Lindberg, ka theksuar se është shumë e lumtur që po vazhdojnë bashkëpunim mes dy zyrave. "Ky vërtet është një bashkëpunim mes kolegësh, ku stafi i të dyja organizatave tona mëson nga njëri-tjetri. Dëshiroj ta përgëzoj kolegun tim z. Osmani për anëtarësimin e ZKA-së së Kosovës në Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT). Pres me padurim që të kemi bashkëpunime me ZKA-në e Kosovës në forumet evropiane të EUROSAT-t dhe në forumet botërore të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)", ka deklaruar ajo.

Memorandumi "Bashkëpunimi për zhvillim institucional me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2020-2023" është hartuar në përputhje me planet dhe objektivat strategjike të ZKA-së, qëllimi afatgjatë i të cilit është ta mbështesë ZKA-në e Kosovës për t'u bërë një institucion suprem auditimi që punon në pajtim standardet dhe parimet e INTOSAI-t (IFPP).

Ky projekt i ka të përcaktuara dy objektiva, të cilat janë: forcimi i disa proceseve organizative për nxitjen e një pune me cilësi të lartë dhe zhvillimi i kapaciteteve për hartimin e raporteve të auditimit të performancës me cilësi më të lartë, të cilat janë të dobishme për palët relevante të interesit. Pas nënshkrimit të memorandumit, Komiteti Drejtues i Projektit për bashkëpunim, i përbërë nga

përfaqësues të ZKA-së Suedeze dhe ZKA-së së Kosovës, mbajtën mbledhjen e rregullt vjetore. Përfaqësuesit e të dyja institucioneve supreme të auditimit diskutuan për nivelin e zbatimit të planit të aktiviteteve për vitin 2020, të arriturat dhe sfidat e projektit si dhe për rezultatet që priten nga marrëveshja e re.

Partneriteti mes ZKA-së të Suedisë dhe asaj të Kosovës daton që nga viti 2011, kur është arritur Marrëveshja e Bashkëpunimit për zhvillimin e kapaciteteve, përmes së cilës ZKA-së së Kosovës i ofrohej mbështetje për ta përmbytur mandatin e saj dhe për t'u bërë një institucion i qëndrueshëm suprem i auditimit, i cili vepron në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira. Ky ka qenë projekti më gjithëpërfshirës zhvillimor i zbatuar në ZKA.



Guvernatori Mehmeti dhe ambasadori Kolly flasin për zhvillimet e fundit në ekonomi

PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur në takim ambasadorin e Zvicrës në vendin tonë, Thomas Kolly. Guvernatori e ka njoftuar ambasadorin zviceran për zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe angazhimin e mëtejshëm të BQK-së për të ndihmuar në rimëkëmbjen e ekonomisë dhe mbajtjes së

sektorit financiar stabil dhe likuid.

Po ashtu, guvernatori Mehmeti e ka informuar ambasadorin Kolly se BQK-ja që nga shpërthimi i pandemisë ka qenë e angazhuar dhe e përkushtuar të kontribuojë në lehtësimin e mëtejshëm të qasjes në financa përmes rolit të saj si rregullator dhe mbikëqyrës i sistemit financiar.

Më tutje, guvernatori falënderoi

shtetin e Zvicrës për mbështetjen që i ka dhënë shtetit të Kosovës dhe BQK-së në shumë projekte si dhe shprehu gatishmërinë që ky bashkëpunim të thellohet edhe më shumë.

Ndërsa ambasadori Kolly ka falënderuar guvernatorin për informatat e ofruara, derisa ka shprehur gatishmërinë në emër të shtetit zviceran që të vazhdohet me bashkëpunimin me BQK-në.



Të rinjtë e Gjilanit fotografitë e vjetra të qytetit i shndërrojnë në piktura

GJILAN, 18 DHJETOR (ER)-Nxënësit e shkollës së mesme të artit pamor "Adem Kastrati" në Gjilan fotografitë e vjetra të këtij qyteti i kanë shndërruar në piktura, duke e shpallur të hapur ekspozitën në Muzeun e Qytetit e titulluar "Gjilani n'reto".

Drejtori i kësaj shkolle, Roland Masurica, e ka falënderuar komunën për mbështetjen e këtij projekti. "Këto fotografi të cilat janë ekspozuar, fokus të veçantë kanë pasur që të na sjellin një nostalgji, një retrospektivë dhe një evolium të qendrës së qytetit në etapa të ndryshme dhe ato figura janë të paraqitura përmes brushës, ngjyrës dhe lapsit", ka thënë

Masurica.

Ndërsa, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Deniza Limani, ka pohuar se ndjehet krenare me këto punime fantastike të nxënësve që pasqyrojnë Gjilanin në retrospektivë. "Është një aktivitet jashtëzakonisht me vlerë. Qëllimi i thirrjes publike të DKRS-së ka qenë mbështetja e të rinjve, sikurse këta sot. Ndihej shumë krenare me këto punime të realizuara nga nxënësit e qytetit tim", është shprehur Limani. Ky ka qenë projekt i organizuar nga organizata joqeveritare Botart Gjilan, me mbështetje të Lutfi Hazirit. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri në mesin e janarit.



Drenasi vlerësohet nga organizata 'Help' për bashkëpunimin të mirë



PODUJEVË, 18 DHJETOR (ER)-Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të premten ka marrë mirënjohje nga përfaqësuesi i organizatës "Help", Gent Saraçi i cili e ka falënderuar këtë komunë, përkatësisht kryeartin për bashkëpunimin e mirë që kanë pasur në realizimin e projektit për t'i ndihmuar bizneset. Komuna e Drenasit,

në fillim të këtij viti, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën "Help" për mbështetjen financiare të bizneseve në Drenas. Në kuadër të këtij memorandumit janë ndihmuar bizneset fillestare dhe ato ekzistuese me pajisje të ndryshme, sipas planit të aplikuar nga vetë bizneset.

Kryetari, Lladrovci ka falënderuar organizatën "Help" për bashkëpunimin e treguar për t'i ndihmuar bizneset e Drenasit dhe ka vlerësuar së një bashkëpunim i tillë është i mirëseardhur edhe në vitet në vazhdim si nga organizata "Help" ashtu nga organizata të tjera të cilat ndihmojnë bizneset në Drenas.

Ministria e Arsimit i dhuron 22 laptopë për shtatë shkolla të Podujevës

PODUJEVË, 18 DHJETOR (ER)-Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pranuar një donacion të dhuruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për shtatë shkolla të kësaj komune. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Fatmir Elezi, ia ka dorëzuar kryetarit Bulliqi një donacion prej 22 laptopëve, dedikuar për shtatë shkolla të

Komunës së Podujevës. Me rastin e pranimit të donacionit, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu, kryetari Bulliqi e ka falënderuar Ministrinë e Arsimit për donacionin e dhuruar, të cilët u janë shpërndarë drejtorëve të shkollave përfituese të laptopëve.



Kryqi i Kuq në Kamenicë dhuron pako me veshmbathje e lodra për fëmijët me nevoja të veçanta

KAMENICË, 18 DHJETOR (ER)-Kryqi i Kuq në Kamenicë në bashkëpunim me bizneset e Komunës së Kamenicës u ka dhuruar pako me veshmbathje dhe lodra fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilët vijnë në mësimet në shkollat e Kamenicës.

Kryetari i Kryqit të Kuq në Kamenicë, Rexhep Morina, ka falënderuar bizneset të cilat me donacionet që dhuruan

arritën që sadopak t'i gëzojnë këta fëmijë. "Me iniciativën e vullnetarëve ishim te disa biznese të cilët na pritën shumë mirë, dhe na dolën në ndihmë që të sigurojmë nga një pako për këta fëmijë. Faleminderit prej pronarëve të bizneseve: salloni i këpucëve 'Forever', 'Haliti-SM', supermarketin 'Driloni'. I falënderojmë nga zemra këta donatorë dhe lutemi për ta që të kenë shëndet e suksese në



punë, në familje e në pasuri", ka thënë ai.

Ndër të tjera Morina ka falënderuar edhe vullnetarët të cilët përgatitën pakot. "Vullnetarët tanë i falënderoj pasi që përgatitën pakot dhe nuk u lodhën asnjëherë. Po ashtu e falënderojmë edhe mësuesen Rrezarta Dërmaku, e cila na ndihmoi në sigurimin e të dhënave të fëmijëve dhe dorëzimin e pakove", është shprehur ai.

KOSOVA PËRBALLË METODAVE ASIMETIRKE TË LUFTËS SPECIALE



Hisen BERISHA

Opiniononi publik është sundimtari suprem i botës, që është e pamundur të mos ecësh, sipas tij. Pra, është një pushtet ideor mbi mendjet e njerëzve siç, ta zëmë, ideja e integritimeve euroatlantike me theks në NATO si akt i sigurisë, qenia pjesë e botës së liberalizuar që ka pushtuar mendjet e njerëzve. Kosova është në një presion të madh të një lufte të orkestruar speciale nga qarqe të vetëdijshme dhe me plan, si dhe nga struktura elektorale dhe rinore të komprometuara ose të keqpërdorura pa vetëdije. Ata janë vënë në shërbime të

këtyre qarqeve dhe misioni i tyre është që duke goditur në çdo sferë të jetës pa kursim, duke përfituar mbi çdo fatkeqësi të qytetarëve dhe shtetit, qoftë edhe për pandeminë Covid-19, duke stisur raporte e qëndrime të strukturave të caktuar evropiane dhe ndërkombëtare siç ishte raporti i disa personave të shërbimit ruso-soros-ian që përgatiten një raport përmes të cilit po përpiqen t'i minojnë proceset politike dhe spektrin politik të Kosovës. Pra, krejt këto janë në shërbim të defunksionalizimit të shtetit të Kosovës dhe sjelljes së situatës deri te ndonjë trazirë sociale të tipit të revolucioneve socialiste, që do ta fundoste përfundimisht Kosovën si shtet i pavarur. Kjo e tëra po përpiket të mbulohet me teoritë e bashkimit kombëtar, si motivi më intrigues për çdo shqiptar të globit por, sipas modelit të

mentorit të tyre, Rexhep Qosja, ku 42 për qind e territorit administrohet nga Serbia përmes eksterritorialitetit të manastireve dhe enklavave, që do ta bëjnë hartën e Kosovës të duket si lëkurë Leopardi. Është koha e fundit që spektri politik në Kosovë të fuqizohen dhe të profilizohen partitë me filozofi të përafërt, në të djathtë dhe të majtë shqiptare. Nuk mund të kemi zgjidhje nacionale nga subjekt që udhëhiqen e janë pjesë e Internacionales Socialiste, që udhëhiqet nga kryetari i PASOCUT grek, grekut George Papandreous, njeriu me antishqiptar dhe antiçam në Ballkan. Ajo që duhet të na inkurajojë është e kaluara historike jo e largët. Sado që po përpiqemi të krijojmë opinione degraduese për shtetin dhe çorientues për qytetarët, historia jo e largët na

mëson se sado që krijon opinione dhe përfiton masat, pa mbështetjen diplomatike ndërkombëtare je një dështim. Fillimviti '90 ishte viti i përkrahjes plebishitare të vizionit dhe misionit të liderit të kosovarëve dhe të lëvizjes për liri, barazi, demokraci dhe shtet, dr. Ibrahim Rugova. LDK-ja e kohës ka numëruar 700.000 anëtarë, diçka mahnitëse. Por, mungesa e sensibilizimit të faktorit ndërkombëtar dhe mbështetjes diplomatike ndërkombëtare nuk e entuziazmonte liderin e mençur, të urtë dhe me dije shkencore, që të vepronte pa maturi, përkundër shumë insinuatave nga brenda dhe jashtë, që të futej në aventurën e luftës. Por, u tregua trim i urtë i "Lahutës" së Fishtës, burrë i urtë që kurrë nuk ngutet, prej mençurisë e jo prej tutës. Kjo është një mësim i nxjerrë për liderët e lëvizjes që po pretendojnë se me opinione dhe

përkrahjen entuziaste do të mund të sjellin ndryshim në skenën politike dhe shtet. Jo, nuk mjaftojnë entuziazmi dhe as përkrahja emocionale nëse nuk e fiton përkrahjen formale diplomatike ndërkombëtare. Këtë e theksoj se nuk iu ndihmon, sado që mund të prodhojë opinione që e ndihmojnë luftën speciale antishtet që po zhvillohet në çdo sferë. As raportet e qarqeve indikative në institucione edhe të BE-së nuk ndihmojnë në këtë mision antishtet përveç pengimit të ecjes përpara. BE-ja është nën presionin e madh të orientimit drejt perspektives dhe ekzistencës së vet me mbështetjen e ShBA-së, apo orientimit drejt presionit ekonomik të ndikimit rus në rajon dhe me këtë të përballet me stagnim si asociacion apo komunitet. Prandaj, fokusimi i energjive duhet të jetë Kosova.

Komuna e Klinës fiton grant mbi 88 mijë euro për mjedis të pastër

KLINË, 18 DHJETOR (ER) - Komuna e Klinës është përfituese e grantit të performancës komunale për mjedis të pastër, ku ka fituar 88 445.00 euro. Pas përfundimit të raundit të dytë të vlerësimit të performancës së komunave në kuadër të grantit të performancës-mjedis i pastër, i lansuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe mbështetur nga organizata gjermane GIZ, komiteti i grantit të performancës ka radhitur Komunën e Klinës në mesin e komunave përfituese të grantit për mjedis të pastër në vlerën prej 88 445.00 eurosh. Vlerësimi i grantit të performancës për mjedis të

pastër është bërë në tri kriteret të qasjes, për tre indikatorë të qeverisjes së mirë të nxjerra nga sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) në Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe tetë indikatorë të menaxhimit të mbeturinave, të nxjerra nga raportimi vjetor i komunave në Agjencinë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës (AMMK) në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Përfitimi i këtij granti është rezultat i punës transparente dhe shërbimeve cilësore që jep Komuna e Klinës, ndërsa mjetet nga përfitimi i grantit do të dedikohen në projekte kapitale për mirëqenien e qytetarëve.



Përfunduan punimet për renovimin e urës së Marashit

Prizren, 18 dhjetor (ER) - Me rastin e përfundimit të punimeve për renovimin e urës së Marashit, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, dhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Osman Krasniqi, kanë vizituar këtë urë, ku dhe panë nga afër punimet e kryera. Me

këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se në kuadër të projektit është bërë rregullimi i rrethojave të urës, duke përdorur elemente të metalit, gurit dhe drurit, ashtu siç e kërkon Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Po ashtu, kryetari Haskuka, duke theksuar se intervenimi në

këtë urë ka marrë pak kohë për shkak se gjendet në qendrën historike të qytetit dhe duhej ta prisnin marrjen e lejeve të duhura nga institucionet përkatëse, deklaroi se gjatë vitit të ardhshëm do ta vazhdojnë punën për rregullimin e të gjitha urave të qytetit.



Lipjani, tani edhe me tregues digjitalë në qytet

LIPJAN, 18 DHJETOR (ER) - Në Komunën e Lipjanit në pjesët

kryesore të qytetit janë vendosur tregues digjitalë. Këta tregues do

të shërbejnë për shumë gjëra të ndryshme për orientim të qyte-

tarëve si dhe do ta bëjnë matjen e kohës dhe temperaturës.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Besa dhe Prishtina, në kërkim të suksesit në Kupën Evropiane

Kampionia në fuqi e Kosovës, Besa Famgas, kërkon sot (e shtunë) fitoren e dytë dhe kualifikimin më tutje në Kupën Evropiane të Hendbollit, kurse Prishtina sot kërkon fitoren e parë në rrethin e tretë të kësaj garë kundër AEK-ut



"Epoka e re"

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Dy klubet e hendbollit të Kosovës, Besa Famgas dhe Prishtina, sot (e shtunë) kërkojnë suksesin në rrethin e tretë të Kupës Evropiane. Kampionia e Kosovës, Besa Famgas, luan ndaj Boracit në ndeshjen e kthimit të raundit të tretë, kurse ndeshjen e parë klubi nga qyteti i Pejës fitoi me rezultat 24:22. Synimi i Besës është kalimi në raundin tjetër, por për të arritur një gjë e tillë i duhet një

paraqitje shumë e mirë për faktin se kundërshtari ka një skuadër cilësore. "Atmosfera është e shkëlqyeshme dhe djemtë tanë udhëtojnë me synim për ta mbrojtur fitoren nga ndeshja e parë. Të vendosur për hapin e radhës në Evropë, për ta rritur emrin e Pejës dhe Besa Famgasit", thuhet në njoftimin e Besës.

Ndërsa skuadra e Prishtinës është e gatshme për ndeshjen e parë kundër skuadrës greke, AEK-un, e cila zhvillohet në Athinë. Ndeshjen e parë kryeqytetasit e Kosovës e

zhvillojnë të shtunën, kurse të dielën e zhvillon ndeshjen e dytë. "AEK-u është ekip shumë i fortë. Ka në përbërje katër lojtarë të Spanjës, një kroat, një serb, një austriak, një brazilian dhe shumë lojtarë kualitativë vendorë. Ekipi ynë është me 100 për qind vendorë. AEK-u është favoriti, por do ta japim maksimumin", ka thënë trajneri i Prishtinës, Taib Kabashi.

Prishtina për këto dy ndeshje është përforcuar me Arbër Currin e Vëllaznimit si dhe Festim Mustafën e Arben Dugollin të Kastriotit.

Fetahu, kryetar i FBK-së edhe për katër vjet

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Arben Fetahu është rizgjedhur kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Kështu u vendos të premtën në Kuvendin e Rregullt Zgjedhor të FBK-së. Nga 29 delegatë sa ishin të pranishëm të gjithë ishin për dhe me asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, Fetahu do ta vazhdojë punën në krye të basketbollit të Kosovës. Ai është pjesë e FBK-së që nga viti 2013. Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë 29 delegatë, kurse ka munguar sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, për shkak të infektimit me Covid-19. Nënkryetarët të FBK-së janë zgjedhur Linda



Shala dhe Artan Kurti. Gjithashtu janë zgjedhur edhe shtatë anëtarë të Bordit: Teuta Abdullahu, Arben Bislimi, Rahman Përteshi, Artan

Qerkini, Alban Ramën, Valton Bilalli, Egzon Fetiu. Ndërkohë në Këshillin Mbikëqyrës janë zgjedhur: Fidan Hamiti, Shaqir Totaj dhe Artan Spahija.

SHKURT

Sot Ballkani - Gjilani, nesër Prishtina - Drita

Sezoni vjeshtor në Superligën e futbollit të Kosovës do të përfundojë në këtë fundjavë ku do të zhvillohen dy ndeshjet e mbetura: Ballkani - Gjilani dhe Prishtina - Drita. Me këto dy ndeshje do të përmbyllet stinori vjeshtor i garave. Ballkani është i dyti në tabelë dhe synim e ka fitoren në këtë ndeshje, por edhe Gjilani luan për rezultat pozitiv. Ndeshja tjetër derbi zhvillohet të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri", ku Prishtina e pret Dritën dhe synon që ta mposhtë në këtë ndeshje dhe ta ngushtojë diferencën e pikëve.

Dardan Berisha, MVP i xhiros 8

Peja ka mundur Sigal Prishtinën 89:94 në derbin e rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës. Dardan Berisha ishte basketbollisti më i dalluar në parket, duke realizuar plot 38 pikë në këtë përballje. Berisha kishte edhe pesë kërcime, tri asistime dhe katër topa të vjedhur, ndërsa indeksin e ndeshjes e kishte 35. Basketbollisti pejan shënoi nëntë trepikësha nga 14 tentime, ndërsa dy herë ishte i saktë për dy pikë nga gjashtë tentime dhe shtatë gjuajtje të lira nga nëntë tentime. Top 5 shënuesit më të mirë të xhiros së tetë janë: Dardan Berisha i Pejës me 38 pikë, Sean Hoehn i Bashkimit me 36, Fisnik Rugova i Bashkimit me 28, Edmond Azemi i Sigal Prishtinës me 25 dhe Musab Mala i Bashkimit me 24.

Kosovare Asllani shpallet futbollistja më e mirë për muajin nëntor

Kosovare Asllani të premtën e ka fituar një çmim tejet të rëndësishëm. Falë paraqitjeve të mira në muajin e kaluar, ajo e fitoi çmimin e futbollistes më të mirë të muajit nëntor. Gjatë këtij muaji ajo shënoi gjashtë gola në pesë paraqitje. Futbollistja mitrovicase është bërë protagoniste me skuadrën e Real Madridit. Ndeshje pas ndeshje, ajo vazhdon t'u shënojë skuadrave kundërshtare.

Interi i shtohet garës për Mustafin

Skuadra e Interit është futur në garë për shërbimet e mbrojtësit Shkodran Mustafi, ka njoftuar "Tuttosport". Klubi italian synon të firmosë parakontratë me Mustafin në janar, në mënyrë që t'i sigurojnë shërbimet e tij për sezonin e ri. 28-vjeçari këtë edicion ka vetëm shtatë paraqitje për Arsenalin në të gjitha garat në këtë edicion dhe gjatë verës do të largohet nga ky klub. Interim për reprezentuesin e Gjermanisë kanë shfaqur edhe Barcelona dhe Eintracht Frankfurti.

Ibrahimi, futbollisti i radhës që e paditë Prishtinën

Kapiteni aktual i Arbërisë, Labinot Ibrahimi, i është shtuar listës së futbollistëve të Superligës, të cilët kanë paditur ish-klubin e tyre, Prishtinën. Arsyeja mbetet e njëjtë: mosrespektimi i kontratës mes klubit dhe lojtarit. "Po, e kam dërguar padinë në FFK për Prishtinën, pasi nuk e ka shlyer borxhin që ka ndaj meje, sipas kontratës. Kam pritur deri tash, por nuk i kanë kryer dhe u detyrova t'i drejtohem federatës. Pres të më ndihmoj FFK-ja, në të kundërtën do t'i drejtohem gjykatës", ka thënë Ibrahimi për "Olle". Përveç Ibrahimit, Prishtinën e kanë paditur edhe Armend Thaçi, Ahmed Januzi dhe Ahmet Haliti.

Lewandowski: Sakrificat e mia u shpërblyen, synoj suksese të tjera

PARIS, 18 DHJETOR - I lumtur për një çmim unik, por më se i merituar. Robert Lewandowski u shpall lojtari më i mirë i vitit nga FIFA, duke mposhtur konkurrencën e dy futbollistëve ikonë të

shkullit të 21-të, Messin dhe Ronaldon. Bomberi polak i cili fitoi gjithçka me Bayernin gjatë këtij viti kalendarik, madje duke shënuar edhe një "thes" me gola, u shfaq shumë i lumtur në intervistën para mediave për fitimin e

Çmimit FIFA "The Best Player" teksa theksoi se tashmë fokusi i tij shkon tek objektivat e radhës. "Fitimi i këtij çmimi është diçka fantastike, një vlerësim që shpërblyen sakrificat e mia. Do të thotë, i kam arritur objektivat.

Nuk e mbaj mendjen te titujt e fituar. Ata kurrë nuk mjaftojnë. Që prej kur kam filluar të luaj futboll mendoj gjithmonë për t'u përmirësuar si lojtar dhe fokusohem tek objektivi i radhës", ka deklaruar Lewandowski.



Vendi i parë kundër të dytit në Superligë

RAHOVEC, 18 DHJETOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e nëntë e Prince Caffè Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja kryesore do të zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Pejës. Vreshtarët ndodhen në vendin e dytë me gjashtë fitore dhe dy humbje, kurse pejanët në vendin e parë me shtatë fitore dhe një humbje,

andaj kjo përballje pritet të jetë shumë interesante. Duel mjaft interesant shihet edhe ai në mes të Bashkimit dhe Golden Eagle Yllit. Prizrenasit kanë tri fitore dhe pesë humbje, kurse therandasit katër fitore dhe katër humbje. Ponte Prizreni, pasi mundi Golden Eagle Yllin, do të përpiqet të vazhdojë me rezultate pozitive, e në këtë xhiro

do të ndeshet me Vëllaznimin. Prizrenasit kanë pesë fitore dhe tri humbje, kurse kuqezinjët tri fitore dhe pesë humbje. Trepça - Sigal Prishtina janë rivalët e vjetër të basketbollit të Kosovës që do të ndeshen në një duel interesant, sepse të dyja skuadrat kanë nga dy fitore dhe gjashtë humbje, duke u renditur në fundin e renditjes.



PRINCE CAFFÈ SUPERLIGA - JAVA 9

Të shtunë takohen:

15:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

17:00 Rahoveci - Peja

Të dielën takohen:

15:00 Ponte Prizreni - Vëllaznimi

17:00 Trepça - Sigal Prishtina

Fury: E mposht Joshuan dhe bëhem boksieri më i mirë i dy epokave

LONDËR, 18 DHJETOR - Boksieri britanik Tyson Fury ka kritikuar Anthony Joshuan se nuk është impenjuar shumë për organizimin e një sfidë mes tyre. Edhe pse prej muajsh pritet një përballje mes tyre, që do t'i unifikonte titujt kampionë bote në peshën e rëndë, ende nuk ka asgjë konkrete. Palët synojnë të zhvillojnë 2 duele vitin e ardhshëm. "Vitin tjetër kjo sfidë duhet të ndodhë me çdo kusht. Ai e kaloi pengesën e fundit kur mposhti Pulevin. Tani jemi të dy të lirë për ta organizuar këtë duel. Mezi po e pres këtë sfidë", u shpreh Fury në një intervistë televizive. "Pasi të zhvilloj këtë sfidë dhe ta mposht Joshua, do t'i them gjithë botës se jam



boksieri më i mirë, që munda kampionët e dy epokave: Klitschkon, Wilderin dhe Joshuan. Në vitin 2015 mposhta Klitschkon që dominonte prej 10 vjetësh. Më pas munda

Wilderin që ishte i pamposhtur dhe vitin tjetër është radha e Joshuas. Më në fund, pas 20 vjetësh, do të kemi një boksier që i ka të gjithë titujt", ka deklaruar Fury.

SHKURT

Hamiltoni rinovon kontratën me Mercedesin

"Plani im është të qëndroj këtu edhe vitin tjetër". Është ky njoftimi që ka publikuar të premten makina gjermane në "Twitter", duke shtuar se së shpejti do të japë edhe lajmin zyrtar të rinovimit të kontratës me pilotin britanik Lewis Hamilton. "Unë mendoj se bashkë me skuadrën kemi shumë gjëra për të bërë dhe shumë fitore të tjera për të arritur. Jo vetëm në sport, por edhe jashtë tij", ka shkruar Hamiltoni. Këtë vit Hamiltoni fitoi titullin e 7-të kampion bote në Formula 1. Ende nuk dihet se për sa vite do ta rinovojë kontratën piloti 35-vjeçar.

Ish-kampioni i botë dënohet me dy vjet burg

Gjykata e Apelit ka konfirmuar dënimin me dy vjet burg për ish-sulmuesin e Juventusit, Udineses dhe Italisë, Vincenzo Iaquina, për armëmbajtje pa leje. Ish-kampionit të Botës me Italinë në vitin 2006, iu gjetën dy pistoleta dhe qindra fishekë. Protagonist kryesor në çështjen e quajtur "Aemilia" ishte babi i Iakuintës, me një të shkuar të errët në botën e kimit. I ati i ish-sulmuesit u dënua me 19 vjet, teksa Apeli uli dënimin në 12 vjet. Sipas autoriteteve përkatëse, armët ishin regjistruar, por kalimi në përdorim tek i ati i lidhur me mafian inkriminonte edhe ish-futbollistin. Operacion ishte një ndër më të mëdhenjtë për asgjësimin e mafias kalabreze të lidhur me eksponentët e Ndrageatas.

Schalke shkarkon trajnerin Baum

Manuel Baum nuk është më trajner i Schalke 04. Skuadra gjermane ka vendosur ta ndërpresë bashkëpunimin me Baum, pas rezultateve të dobëta këtë sezon. Schalke nuk ka shijuar ende fitoren këtë sezon dhe rrezikon seriozisht rënien nga Bundesliga, duke u renditur në vendin e fundit me vetëm katër pikë. Vendin e Baumit përkohësisht do ta zë Huub Stevens.

Mertensi mungon një muaj

Dries Mertens e ka mbyllur para kohe vitin 2020 në futboll. Klubi i kaltër njoftoi se "sulmuesi, i cili u zëvendësua dje gjatë ndeshjes me Interin, iu nënshtrua testeve diagnostikuese në klinikën "Pineta Grande", të cilat zbuluan një ndrydhje të shkallës së parë/të dytë në kyçin e këmbës së majtë. Gjendja e tij do të rivlerësohet brenda 3 javësh. Mertens tashmë ka filluar fazën e rehabilitimit që do të vazhdojë në Belgjikë gjatë periudhës së Krishtlindjes". Gattuso do të duhet të presë deri në javën e parë të janarit për të marrë lajme të reja mbi gjendjen fizike të sulmuesit të tij. Rekordmeni i golave në shtëpinë e Napolit do ta humbasë transfertën në "Olimpico" kundër Lazios, atë kundër Cagliarit dhe ndeshjet në shtëpi me Torinon dhe Spezian.

Dy ëndrrat e Dybalas

Paulo Dybala dhe Juventusit janë afër rinovimit të kontratës. Bisedimet vazhdojnë prej kohësh dhe argentinasi pritet ta shohim edhe shumë vite me fanellën bardhezi mbi supe. Në prononcimin e fundit, 27-vjeçari latin lëshon mesazhe dashurie për kampionët e Italisë dhe zbulon dy ëndrrat e tij të mëdha. "Kam kaluar shumë momente të bukura këtu dhe kemi fituar shumë trofe. S'e harroj kur erdha te Juventusit. Ishte një emocion i veçantë. I njëjti edhe kur veshja fanellën bardhezi për herë të parë. Shpresoj që këto emocione të shtohen dhe të jenë të shumta edhe në vijim, duke filluar prej finales së Superkupës që do ta luajmë ndaj Napolit në janar", ka thënë Dybala. "Ëndrrat e mia? Dy ëndrra kam, edhe pse aspak të lehta. Dua të fitoj Ligën e Kampionëve, sigurisht me Juventusin. Më pas dua ta fitoj Botërorin me Argentinën", ka shtuar argentinasi.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 10:30 në hapësirat e komunës - në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës në adresën Rr: "Bedri Gjinaj" - Nr.Post: 40000 do të organizohet debat publik nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhS3IKdEVTV1F0NTFvZz09>

Meeting ID: 966 277 1284

Passcode: 112233

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Berlin Chemie/A.Menarini Kosovo" L.L.C, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 71067858.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

